



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA	
Sh. 02	Nr. 21625
U. 02	Br. 21625
Nr. i faq. 4	Data: 08/07
Br. str. KAMENICË/A	Datum: 2024



Procesverbali i mbajtjes së dëgjimit buxhetor me stafin mjekësor

Dëgjimi me stafin mjekësor është organizuar nga Komisioni për organizimin e dëgjimeve buxhetore në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit dhe Kuvendin Komunal.

Njoftimet për grupet e interesit për organizimin dëgjimit buxhetor janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet janë bërë në Uebfaqe, në Facebook dhe në Platformën e Konsultimeve Publike.

Publikimet:

UBFAQE:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=878912584271075&set=pcb.878912930937707>

Me 02.07.2024 dëgjimi publik është mbajtur me stafin mjekësor në QKMF duke filluar nga ora 10:00.

Pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin: Drejtoreshë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Ardita Dërmaku, Drejtoresha për Shëndetësi dhe mirëqenje Sociale, Erona Hoda, Zyrtari Kryesor Financiar, Naser Hashani, zyrtarë të tjerë komunal përgjegjës për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore.

Drejtoresha Erona Hoda ka hapur këtë dëgjim: Faleminderit për pjesmarren, jemi mbledh për me I diskutu në këtë dëgjim për dëgjimet buxhetore për buxhetin komunal për vitin 2025, për me e pa se cilat janë kërkesat, dhe se qka na duhet me punu për vitin e ardhshëm, cilat janë nevojat e QKMF-së, në proces I kemi ambullantat në fshatin Busavatë dhe Topanicë, furnizimi me barnat për penzionist, asgjësimi I barnave nga institute I shëndetësis që edhe është në procesin e fundit të prokurimit dhe furnizimi me barna për urgjencë, material shpenzues medicina, furnizim me pagesa dhe stomatologjik. Ne jemi mbledh këtu që të ndegjojm dhe kërkesat e juaja se qka ka nevoj QKMF-ja se ku duhet me u orjentu buxheti për vitin 2025, nëse keni kërkesa është mirë me I diskutu bashkarisht dhe me pa se qka mundemi me ba për QKMF-n.

Drejtoresha Ardita Dërmaku prezanton buxhetin: Kam knaqsin të ndaj me juve detajet kryesore të buxhetit për vitin e ardhshëm, me theks të veçantë sa i përket investimeve kapitale dhe subvencioneve. Kjo është një mundësi që të merrni pjesë aktivisht në planifikimin dhe shpërndarjen e resurseve tona të ardhshme. Sygjerimet dhe komentet e juaja kanë një rëndësi shumë të madhe sepse bashkarisht më kërkesat e juaja do ta përfitojmë një draft buxhet për vitin e ardhshëm. Buxheti komunal i planifikuar për vitin 2025 do të jetë 15,282,684.00euro, ku pjesa e dedikuar për investimeve kapitale arrin shumën 2.6 milion, ndërsa pjesa për subvencione arrin shumën 885,000.00 euro, ndërsa sa i përket grantit të shëndetësis ka një ngritje nga 1.8 milion për vitin 2025 do të jetë 2 milion Euro. Nga ju pres një kontribut të madhë ku gjatë këtij takimi pres që përmes prioriteteve të juaja ti paraqitni në ato kërkesa që ju i konsideroni më të rëndësishme.

Kërkesat e mjekëve ishin të ndryshme si:

Drejtori i QKMF-së Latif Sylaj: Ne kemi diskutuar në takime të ndryshme me stafin mjekësor për kërkesat që ka nevojë Qkmf si dhe stafi. Për 2025 i kemi shënuar disa që mendoj se janë të realizueshme, e para është sigurimi i dy ambulancave që është nevojë emergjence jo urgjente, renovimi i objektit të barantores publike, është shumë e vjetër dhe ka nevojë që të renovohet komplet, ku për barna nevojiten kushte specifike, shkallët emergjente që rregullohen në rast të ndonjë zjarri apo tërmeti QKMF nuk i posedon shkallët emergjente, inventari për zyre dhe për ordianca që i përfshin edhe qmf dhe amft, fasadimi i objektit ndoshta është problematik për futjen si projekt në buxhet por mendoj se ka nevojë me u rregullu.

Doktor Asllani: QKMF nuk është veq kjo qender por ne kemi edhe Qmf dhe Amf, në Rogan duhet me pas parasysh që në rogan është bërë 24h, qëllimi jon është që qytetarëve të ju ofrojmë shërbime sa më të afert, në kuadër jemi shumë këq, urgjenca duhet të jëtë njësi e veçantë. Me ngrohtoren e QKMFs jemi shumë keq, ne kërkojmë që të bëhet një zgjidhje në këtë aspekt, të bëhet funksionale dhe ekonomike të bëhet me rrymë.

Ahmet Sylaj: Si pikë e parë për investim kapital që duhet me e nda komuna është ngrohja qëndrore, shopretat që ngrohemi janë në gjendjen shumë të keqe, e kërkojmë për vitin tjetër të rregullohet sepse kemi problem me ngrohjen gjatë dimrit.

Drejtoresha Euron: Kërkesat e tjera janë për përmirësim të infrastrukturës ose investim në paisje pikrisht janë këto që na interesojnë më shumë, qështja e organizimit të mbrendshëm që QKMF-së ne veq se kemi biseduar me kryetarin dhe po e ndaj me juve si informacion, veq se jemi duke punuar në një draft për organizimin e punës brenda QKMF-së, që të orfohen shërbimet po edhe të jetë e organizimeve puna e stafit që do të jetë edhe më e lehtë me funksionu si staf.

Drejtori i QKMFs Latif Sylja: Problemi kryesor është jo vetëm mirmbajtja e klimave por edhe mirmbajtja e gjitha aparaturave edhe mjeksore dhe laboratorike, ne duhet vetë që ti

rregullojmë, kërkoj nga ju që të gjinden një zgjidhje dhe të rregullohet ky problem, nuk bëhet fjalë veq me klimen por edhe aparturat e tjera që

Doktor Asllani: Nga lista esenciale e barnave ka enert secili, nuk mundesh me ba dallime, tek persona e moshuar furnizimi me barna jashtë listes esenciale nuk jamë pajtuar me pjesen ku shënon të gjithë të moshuarit mbi moshën 65 vjet, kemi raste raste sociale, ki raste që janë të sëmurë kronik që janë nën 65 vjet dhe nuk mundesh me ja dhënë barnën që I kërkohet të përdor, dhe mendoj që të shtohen edhe kto raste.

Drejtori i QKMFs Latif Sylja: Kemi edhe rregullimin dhe asfaltimin e parkingut, prishtja e objektit të vjeter ku ka qenë më heret rendgeni.

Drejtoresha Arditë përgjigjet: Sa I përket renovimit të pjesës së barnatores, ne e kemi nënshkruar një kontratë në vler 300,000.00 euro, mirmbajtje teknike të objekteve komunale, në kuadër të ksaj marrëveshje ka me hy edhe renovimi i barnatores.

Doktor Asllani: si është puna e këtyre pozitave të stafit, si është e planifikume në paga dhe mëditje, ku është pengesa?

Zyrtari Naseri: Për pozitën që I specifikon ju, unë vetëm I marë pozitën që mi dergoni të gatshme dhe I vendosi në sistem, por edhe qështja e rritjes së stafit tash kemi me pas problem edhe për shkak të regjistrimit të popullsisë që kemi ulje në banor, tash a plotësohen kriteret edhe për këta punëtor që I ka QKMF-ja, unë e kuptoj që nevoja e juaj është shumë e madhe.

	Propozuesi	Propozimi	Formë e Kontaktit
1.	Latif Sylaj	Dy Ambulanca, Renovimi I objektit të barnatores, Shkallët emergjente, Invertari për zyre të QKMFs dhe ordinancat QMF dhe AMF-t, Fasadimi I objektit të QKMF-s Mirmbajtja e klimave dhe aparaturave mjeksore dhe laboratorike, Regullimi dhe asfaltimi I parkingut, Prishja e objektit të vjetër- ishRentgenit.	Me telefon
2.	Asllan Dërmaku	Shtimi i kuadrove mjeksore, Regullimi I ngrohjes së QKMFs- ngrohtore me rryme,	Me telefon


		Shtimi i rasteve sociale dhe me sëmundje kronike në listen e barnave,	
3.	Ahmet Sylaj	Rregullimi i ngrohjes së QKMF-s	Me telefon

Të gjitha këto kërkesa e stafit mjekësor janë evidentuar nga anëtarët e komisionit për organizimin e dëgjimeve buxhetore, dhe ato që kanë prioritet më shumë do të inkuorohen në projekt buxhet.

Pasi që nuk kishte më kërkesa nga banorët, takimi ka mbaruar në orën 10:40 .

Procesmbajtëse:

Samire Krasniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Lista e pjesëmarrjes së qytetarëve për dëgjimin buxhetor në QKMF me Stafin Mjekësor

Data: 02.07.2024

Ora: 10:00

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i telefonit	Email adresa	Gjinia	Përkatësia etnike	Nënshkrimi ¹²
1.	Dr. Lutfi Sllaj			M	Shqiptar	[Signature]
2.	Euronë Hoda			F	Shqiptare	[Signature]
3.	Shyri Morica			M	Shqiptar	[Signature]
4.	Dr. Arjan Dera			M	Shqiptar	[Signature]
5.	Armen Sllaj			M	SHQIPTAR	[Signature]
6.						
7.						
8.						
9.						
10.						
11.						
12.						
13.						
14.						
15.						
16.						

¹ SHQ: Me këtë nënshkrim, i jap leje të plotë Komunës për të më fotografuar, dhe për të bërë xhirime të imazhit dhe zërit tim me qëllim të krijimit të përmbajtjes për komunikim, si dhe ta përdorë këtë për çdo media, qoftë elektronike apo të shtypur. **SRB:** Ovim potpisom dajem punu dozvolu Opština da me fotografiše i snima mene i moj glas u svrhu kreiranja komunikacionog sadržaja, kao i da isto koristi za bilo koji medij, bilo da je elektronski ili štampan.

² SHQ: Me këtë nënshkrim, unë jap pëlqimin tim që Komuna të përpunojë të dhënat e mia personale për qëllime të ligjshme, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. **SRB:** Ovim potpisom dajem svoju saglasnost da Opština obrađuje moje lične podatke u zakonske svrhe, u skladu sa Zakonom o zaštiti podataka o ličnosti na Kosovu.